VENDIM
Nr. 18/2017

PËR KTHIMIN E DOSJEVE TË KANDIDATËVE QË KANË SHPREHUR INTERESIN PËR TË KANDIDUAR PËR INSTITUCIONET E RIVLERËSIMIT TEK AVOKATI I POPULLIT PËR RIPLOTËSIM TË DOKUMENTACIONIT

Në mbështetje të nenit 78, të Kushtetutës, të neneve 71 dhe 113, të Kodit të Procedurave Administrative, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. T'i kthejë Avokatit të Popullit dosjet e depozituara të kandidatëve që kanë shprehur interesin për të kandiduar për institucionet e rivlerësimit. Avokati i Popullit, brenda 2 ditëve nga marrja në dorëzim e dosjeve të depozituara të kandidatëve, që kanë shprehur interesin për të kandiduar për institucionet e rivlerësimit, njofton kandidatët që nuk kanë plotësuar kriteret formale për riplotësimin e dokumentacionit, kur kjo gjë është e mundur në kuadër të dokumentacionit të nevojshëm që vërteton përmbushjen e kritereve ligjore. Kandidatët, brenda 7 ditëve nga dita e njoftimit prej Avokatit të Popullit, paraqesin dokumentacionin e nevojshëm për riplotësim të dokumentacionit përkatës pranë këtij institucioni, sipas neneve 6 dhe 7, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". I gjithë procesi zhvillohet nën monitorimin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

II. Avokati i Popullit, sipas pikës I, të këtij vendimi, për vlerësimin e kandidatëve, ndjek procedurat dhe afatet procedurale të përcaktuara në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

III. Kuvendi pezullon procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve, sipas ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", deri në ridërgimin e listave nga Avokati i Popullit, sipas këtij ligji.

IV. Vendimi i Kuvendit nr. 14/2017, "Për kthimin e dosjeve të kandidatëve që kanë shprehur interesin për të kandiduar për institucionet e rivlerësimit tek Avokati i Popullit për riplotësim të dokumentacionit dhe rihapjen e thirrjes për paraqitjen e shprehjes së interesit nga aplikantë të rinj për pozicionet e të gjithë anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit" shfuqizohet.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 16.3.2017